



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 9 mars 2015  
Nr. ref.:RK778/15

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI158/14**

Parashtrues

**Bahri Veseli**

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 314/2013, të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren P. nr. 17/2013, të 7 majit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar i  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bahri Veseli, me vendbanim në Prishtinë, të cilin e përfaqëson avokati z. Mentor Neziri nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 153/2014, të 4 gushtit 2014, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR. nr. 314/2013, të 29 prillit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P. nr. 17/2013, të 7 majit 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PML. nr. 153/2014] të 4 gushtit 2014, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PAKR. nr. 314/2013] të 29 prillit 2014 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren [P. nr. 17/2013] të 7 majit 2013, me të cilët pretendohet të jenë shkelur dispozitat e procedurës penale në dëm të parashtruesit të kërkesës.

## **Baza juridike**

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 21 tetor 2014, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI158/14, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI158/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
7. Më 14 nëntor 2014, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Më 7 maj 2013, Gjykata Themelore në Prizren nxori Aktgjykimin [P. nr. 17/2013] me të cilin e dënoi parashtruesin e kërkesës me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 2.500 euro për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe substancave psikotropike nga neni 229.2 lidhur me nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
10. Parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë brenda afatit ligjor kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 17/2013], të 7 majit 2013.

11. Më 29 prill 2014, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [PAKR. 314/2013] me të cilin aprovoi pjesërisht ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke e zvogëluar dënimin me burg prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj në 2 (dy) vjet burg, dhe vërtetoi dënimin me gjobë.
12. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale.
13. Më 4 gusht 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Pml. nr. 153/2014] me të cilin aprovoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë. Në aktgjykim, Gjykata Supreme theksoi që: *„Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, NDYSHOHEN aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren Pn.nr.17/2013 date 7.5.2014 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.314/2013 date 29.4.2014, vetëm sa i parket cilësimit juridik, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës veprimet e të dënuarit juridikisht i cilëson si vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në tentative, nga neni 229 par. 1 lidhur me nenin 20 të KPK... Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i paprekur”.*

## **Ligji relevant**

### ***Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës***

Neni 20. Tentativa: *„Kushdo që me dashje ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar, ai konsiderohet se ka tentuar të kryejë vepër penale“.*

Neni 229: *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike:*

[...]

Paragrafi 2: *„Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me gjobë dhe me burgim prej një deri në tetë vjet.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

14. Parashtruesi në kërkesën e tij thekson se ai konsideron se të gjitha gjykatat kishin bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në dëm të të dënuarit, me çka është shkelur ligji penal dhe ligji i procedurës penale.
15. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën:

*„Që Gjykata ta aprovon si të bazuar Kërkesën për Vlersimin E Kushtetutshmeris së Aktgjykimeve të kundërshtuara, dhe të vleron se që të*

*tri Gjykatat kan bërë me Aktgjykimet e tyre Shkelje të Ligjit Penal dhe dispozitave kushtetuese qe ka te bëjnë me të drejtat e të akuzuarve dhe për gjykim të drejt dhe të gjitha këto Aktgjykime të anulohen, dhe të dënuarin ta liroj nga akuza në mungesë të provave“.*

### **Pranueshmëria e kërkesës**

16. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

18. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) d) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar”*

19. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit shqyrtohet nga aspekti i shkeljes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka përmendur konkretisht në kërkesën e tij se cilat të drejta dhe liri kushtetuese i janë shkelur me aktgjykimet, të cilat ai i konteston, edhe pse me nenin 48 të Ligjit parashihet:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

20. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi ka bazuar kërkesën e tij në shkelje të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, prandaj Gjykata konstaton se ajo çfarë parashtruesi ngre në kërkesë është çështje e ligjshmërisë, dhe jo e kushtetutshmërisë.

21. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në Aktgjykimin [PML. nr. 153/2014] i ishte përgjigjur pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të Kodit penal dhe të Kodit të procedurës penale, kur theksoi:... „se në dem të dënuarit (parashtruesit të kërkesës) është shkelur ligji penal, meqenëse është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi , shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikeve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par. 2 të KPK lidhur me nenin 23 të KPK, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”. Gjykata Supreme konkludoi në Aktgjykim se: „... edhe pse e ka ndryshuar cilësimin juridik të veprave

*penale për të cilët janë dënuar të dënuarit, sa i përket dënimeve nuk ka gjet rrethana të cilat do të ndikonin në uljen e dënimeve të shqiptuar andaj edhe në këtë drejtim aktgjykimet kane mbet të pandryshuara”.*

22. Bazuar në këtë, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta është i qartë dhe i argumentuar mirë, dhe se procedurat nuk ishin të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
23. Gjykata Kushtetuese më tej thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu Rastin KI70/11 parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për pranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
24. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës në rastin e tij nuk mund të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e dispozitave kushtetuese (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
25. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri, duke pasur parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar cenon të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë ose KEDNJ.
26. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 janar 2015, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Snezhana Botusharova

Prof. dr. Enver Hasani

